



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/266  
Datë: 08.08.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 7, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr.08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 gusht 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës me vetëiniciativë për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të cilat janë të nevojshme për realizimin e Projektit Infrastrukturor për Interes Publik - Ndërtimi i "Urës" mbi Lumin Ibër që lidh Mitrovicën Veriore dhe Mitrovicën Jugore, Zona Kadastrale Mitrovicë e Veriut, Komuna Mitrovicë e Veriut, sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Mjetet financiare për pagesën e shpronësimit dhe obligimeve tjera që mund të rrjedhin si rezultat i procesit të shpronësimit do të sigurohen nga buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës, në Departamentin e Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës).
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/266  
Datë: 08.08.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3, nënparagrafi 1.33, dhe nenit 17, nënparagrafi 2.3, të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, i ndryshuar dhe i plotësuar me nenin 1, paragrafi 3, dhe nenin 3, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-088, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 gusht 2025, merr këtë:

**V E N D I M**


1. Caktohen zonat e shërbimit për ofruesit e shërbimeve të ujit në Republikën e Kosovës.
2. Territori i Republikës së Kosovës organizohet në shtatë (7) zona të shërbimit.
3. Zona e shërbimit e Prishtinës, e mbuluar nga Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" Sh. A., përfshin territorin e komunave:
  - 3.1. Podujevë;
  - 3.2. Vushtrri - vetëm vendbanimet:
    - 3.2.1. Stanoc i Poshtëm;
    - 3.2.2. Prelluzhë;
  - 3.3. Prishtinë;
  - 3.4. Obiliq;
  - 3.5. Drenas;
  - 3.6. Fushë - Kosovë;
  - 3.7. Graçanicë;
  - 3.8. Lipjan;
  - 3.9. Shtime.
4. Zona e shërbimit e Mitrovicës, e mbuluar nga Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Mitrovica" Sh. A., përfshin territorin e komunave:
  - 4.1. Leposaviq;
  - 4.2. Zveçan;
  - 4.3. Zubin - Potok;
  - 4.4. Mitrovicë - Veri;
  - 4.5. Mitrovicë - Jug;
  - 4.6. Vushtrri - pa vendbanimet në zonën e shërbimit të Prishtinës nga pika 3.2 e këtij Vendimi;
  - 4.7. Skenderaj.



5. Zona e shërbimit e Pejës, e mbuluar nga Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Hidrodrini" Sh. A., përfshin territorin e komunave:
  - 5.1. Istog;
  - 5.2. Pejë;
  - 5.3. Klinë;
  - 5.4. Deçan;
  - 5.5. Junik.
6. Zona e shërbimit e Gjakovës, e mbuluar nga Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Gjakova" Sh. A., përfshin territorin e komunave:
  - 6.1. Gjakovë;
  - 6.2. Rahovec;
  - 6.3. Prizren - vetëm vendbanimet:
    - 6.3.1. Breg i Drinit;
    - 6.3.2. Dedaj i Epërm;
    - 6.3.3. Dedaj i Ulët;
    - 6.3.4. Krajë;
    - 6.3.5. Krushë e Vogël;
    - 6.3.6. Lubizhdë e Hasit;
    - 6.3.7. Lukinaj;
    - 6.3.8. Murselaj;
    - 6.3.9. Piranë;
    - 6.3.10. Qëndresë e Epërme (Randobravë e Epërme);
    - 6.3.11. Qëndresë e Ulët (Randobravë e Ulët);
    - 6.3.12. Romajë;
    - 6.3.13. Shëngjergj;
    - 6.3.14. Zym.
7. Zona e shërbimit e Prizrenit, e mbuluar nga Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Hidroregjioni Jugor" Sh. A., përfshin territorin e komunave:
  - 7.1. Malishevë;
  - 7.2. Suharekë;
  - 7.3. Mamushë;
  - 7.4. Prizren - pa vendbanimet në zonën e shërbimit të Gjakovës nga pika 6.3 e këtij Vendimi;
  - 7.5. Dragash.
8. Zona e shërbimit e Ferizajt, e mbuluar nga Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Bifurkacioni" Sh. A., përfshin territorin e komunave:
  - 8.1. Ferizaj;
  - 8.2. Shtërpçë;
  - 8.3. Kaçanik;
  - 8.4. Han i Elezit.

9. Zona e shërbimit e Gjilanit, e mbuluar nga Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Hidromorava" Sh. A., përfshin territorin e komunave:
- 9.1. Kamenicë;
  - 9.2. Novobërdë;
  - 9.3. Ranillug;
  - 9.4. Gjilan;
  - 9.5. Viti;
  - 9.6. Partesh;
  - 9.7. Klllokot.
10. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/266

Datë: 08.08.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 5 paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar me nenin 3 të Ligjit Nr. 04/L-111, dhe nenit 198 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 gusht 2025, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet ndryshimi i Statutit të Kompanisë Rajonale të Ujësllësit "Mitrovica" Sh. A., i propozuar me Vendimin e bashkëngjitur të Bordit të Drejtorëve.
2. Obligohet Kompania Rajonale e Ujësllësit "Mitrovica" Sh. A. të përgatisë versionin e konsoliduar të Statutit dhe ta dorëzojë në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- KRU, "Mitrovica", Sh. A.
- Arkivit të Qeverisë



Bordi i Drejtorëve të KRU, Mitrovica, Sh.A i emëruar sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës- Vendimi Nr.09/81, të datës 01.06.2022, duke pasur parasysh zgjerimin dhe marrjen në menaxhim në mbledhjen e rregullt nr. 06/2025 merr:

### VENDIM

I. Miratohet propozimi për ndryshimin e Statutit të Shoqërisë.

II. Neni 3 (Përfaqësitë e Shoqërisë) i Statutit riformulohet në tërësi si vijon:

1. Në përputhje me këtë statut dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, Shoqëria mund të hapë njësi, degë, përfaqësi, filiale ose shoqëri të tjera në Republikën e Kosovës dhe jashtë saj.

2. Shoqëria ka këto njësi që mbulojnë komunat përkatëse:

2. Njësia Mitrovicë Jugore;
- 2.1. Njësia Mitrovicë e Veriut dhe Zveçan;
- 2.2. Njësia Leposaviq;
- 2.3. Njësia Skenderaj;
- 2.4. Njësia Vushtri;
- 2.5. Njësia Zubin-Potok.

III. Ndryshimi i Statutit i dorëzohet aksionarit për veprim të mëtejshëm për atë sa kërkohet sipas legjislacionit në fuqi.

IV. Obligohet Sekretari i Ndërmarrjes të përgatisë versionin e konsoliduar të Statutit për dorëzim në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, pas veprimeve të nevojshme të aksionarit.

V. Ky vendim hyi në fuqi menjëherë.

Vendimi ju dërgohet:

1. Palës;
2. Sekretares së kompanisë
3. Arkives

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve

Kumrije Kelmendi-Alliri

